

Njoftim për hapjen e studimeve në Masterin Ekzekutiv në “Planifikim dhe zhvillimi ekonomik territorial i zonave rurale”

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, hap në vitin akademik 2020- 2021, Masterin Ekzekutiv (ME) në “Planifikim dhe zhvillimi ekonomik territorial i zonave rurale”. Kjo diplomë e ciklit të tretë të studimeve (niveli i 8 kualifikimit sipas Kornizës shqiptare të kualifikimeve) i drejtohet të gjithë ekonomistëve, juristëve, ekspertëve të orgnizimit dhe planifikimit të territorit, ekspertëve të bujqësisë, aktorëve dhe vendimarrësve në nivel lokal dhe qëndror të cilët duan të thellojnë njohuritë e tyre në fushat e ekonomisë, planifikimit të territorit, zhvillimit rural, administrimit dhe zhvillimit lokal, politikave dhe vlerësimit të instrumentave, hartimit dhe vlerësimit të projekteve, teknologjive të informacionit gjeografik, etj. Ky ME është hartuar nga një grup pedagogësh nga disa universitete evropiane (në Francë, Gjermani dhe Greqi) dhe përmledh informacionet më të përditësuara rreth këtyre fushave sot në botë, por me një fokus të veçantë për Shqipërinë.

Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të tretë të studimeve ME në “Planifikim dhe zhvillimi ekonomik territorial i zonave rurale” janë si më poshtë :

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në këtë program studimi, profesionistë të cilët kanë një eksperiencë pune jo më të shkurtër se 2 (dy) vite në fushat e ekonomisë, urbanistikës, bujqësisë, mjedisit, drejtësisë, shoqërisë civile si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Eksperienca e punësimit duhet të vërtetohet.
2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën “Master Ekzekutiv” individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “Master Shkencor”, ose ”Diplomë të integruar” në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë vijojnë:
 - a. kriterin e meritës. Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të dytë (Master Shkencor) ose në “Diplomën e integruar”, të jetë mbi 8.0. Në rast se ka ende kuota të lira, nuk do përjashtohen aplikantët me mesatare më të ulët, por në asnjë rast më të ulët se 7.5.
 - b. kriterit e rëndësisë, (koeficienti i profilit të studimeve master shkencor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FEA_s).
 - c. Kuotave të paracaktuara nga FEA.
3. Njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në nivelin C1. Nëse individi ka fituar një diplomë

të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë pranë “Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural” (Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Godina A, zyra 221) dokumentet e mëposhtme:

1. Fotokopje të mjetit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti).
2. Dy fotografi.
3. Formulari i aplikimit i plotësuar.
4. Mandat pagesa.
5. Vërtetim nga qendra e punës për vjetërsinë në punë.
6. Diploma e noterizuar dhe lista e notave për diplomën më të lartë të fituar.
7. Vërtetim për nivelin e njohjes së gjuhës së huaj, sipas testeve të njohura nga MASR.

Aplikimet janë të hapura deri më datën 20.12.2020.